

Në rast se liderët e partive politike nuk do të gjejnë zgjidhje për tejkalimin e ngërçit politik, atëherë presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, të premtën, eventualisht të martën, me dekret të veçantë do ta shpërndajë Kuvendin, më pas do t'i shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Lajmin e kanë konfirmuar burime mirë të informuara të “Epokës së re”. Po këto burime kanë bërë me dije se Kosova është vonuar në krijimin e institucioneve, prandaj nuk ka kohë për ta krijuar qeverinë me procedurë të rregullt për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit. /epoka e re/